



## Rrjeti i Organizatave Qytetare për Partneritet për Qeverisje të Hapur

### Parime dhe struktura të rrjetit

#### Hyrja - çfarë është partneriteti për qeverisje të hapur?

Partneriteti për qeverisje të hapur (në tekstin e mëtejshëm PQH) është iniciativë ndërkombëtare vullnetare, e cila synon të sigurojë angazhime specifike nga qeveritë për qytetarët e tyre që të promovojnë transparencën, të nxitin pjesëmarrjen e qytetarëve, të luftojnë korrupsionin dhe të shfrytëzojnë teknologjitë e reja që të përforcohet qeverisja/udhëheqja e mirë.

PQH-ja u iniciua nga 8 vende dhe 8 organizata ndërkombëtare, në vitin 2011, si një partneritet i përbashkët për të përparuar transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e pushteteve. Sot në këtë iniciativë marrin pjesë 79 shtete anëtare dhe një numër i madh organizatash të shoqërisë qytetare.

Që të bëhen pjesë e iniciativës për PQH shtetet kandidate duhet të mbështetin Deklaratën për Pushtet të Hapur, të përgatisin plane aksionare nacionale dyvjeçare të përpiluara me konsultime publike, të informojnë rregullisht mbi progresin, të punojnë me shoqërinë qytetare që të arrijnë angazhimet e dakorduara dhe të obligohen se do të japin raporte të pavarura mbi përparimin e tyre nëpërmjet mekanizmit për informim të pavarur. Përgatitja e Planit aksionar për PQH duhet të jetë inkluziv, që nënkupton se kontributin e vet në këtë proces duhet të japin palët e ndryshme të prekura, duke përfshirë edhe administratën shtetërore, shoqërinë qytetare, pushtetet lokale, sektorin e biznesit dhe bashkësinë akademike.

Sektori qytetar akumulon një energji enorme kreative e cila duhet të shfrytëzohet në mënyrë pro/(më)aktive në sektorin publik nëpërmjet përmirësimit dhe kujdesit për kulturën e gjithëpërfshirjes dhe respektimit të të drejtave të të gjithë qytetarëve në procesin e krijimit të politikave dhe marrjen e vendimeve, ligjeve dhe qasjen tek informacionet.

Vlera kryesore ku bazohet PQH-ja si iniciativë për ndërtimin e partneritetit midis institucioneve shtetërore dhe qytetarëve (sektori qytetar dhe i biznesit) nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të masave të cilat do të nënkuptojnë përparim të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së institucioneve publike ndaj qytetarëve.

Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e kësaj iniciative nga viti 2011 dhe ka miratuar katër plane aksionare nacionale (në vitin 2012, 2014, 2016 dhe 2018). Koordinator i aktiviteteve qeveritare për PQH-në është Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA). Planet aksionare përgatiten në konsultim me organizatat qytetare. MSHIA-ja dorëzon dhe shpall në faqen e vet zyrtare në internet <http://www.mioa.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership> thirrje për konsultime, projekt-versione dhe versione finale të planeve aksionare nacionale (PAN) dhe raporte mbi përparimin në zbatimin e tyre, si dhe raporte dhe gjetje të Mekanizmit të pavarur për njoftim. Pas miratimit të PAN-it të katërt 2018-2020, janë formuar (7) grupe pune për zbatimin e prioritetëve me përfaqësues të OQ-ve, të institucioneve, të organizatave ndërkombëtare dhe të akademisë.

## **Pse rrjeti i organizatave qytetare dhe cili do të jetë roli i tij?**

Rrjeti i organizatave qytetare për partneritet për qeverisje të hapur formohet në prag të përgatitjes së planit (të pestë) aksionar nacional, me qëllim që organizatat qytetare të veprojnë dhe të ndikojnë në mënyrë më të organizuar mbi krijimin e tij, si edhe të nxitin dhe monitorojnë zbatimin e planeve aksionare ekzistuese dhe të ardhme.

Roli i rrjetit është të mobilizojë dhe koordinojë përfaqësimin e shoqërisë qytetare në çështjet e PQH-së.

Rrjeti përfaqëson një formë të organizuar të veprimit sipas çështjes së PQH-së në sektorin qytetar, d.m.th.

- Rrjeti i organizatave qytetare aktive të cilat me përkushtim do t'i nxitin pushtetet dhe institucionet e tjera që të punojnë më mirë nëpërmjet transparencës, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies së zmadhuar;
- Iniciativë e organizuar qytetare e cila do të udhëheqë, monitorojë dhe promovojë procesin, por në të njëjtën kohë do të shkojë në aktivitetet e rregullta të Qeverisë dhe do të ushtrojë presion inovativ.

Sipas formës së vet është rrjet joformal, me strukturë dhe koordinim të qartë organizativ.

## **Qëllimet e rrjetit**

Qëllimi themelor i rrjetit është koordinimi dhe përforsimi i zërit të organizatave qytetare të cilat angazhohen për pjesëmarrjen, transparencën dhe llogaridhënien e pushteteve.

Rrjeti do të angazhohet për fillimin, nxitjen, mbështetjen, zbatimin dhe monitorimin e PHQ-së dhe për nxitjen e pushteteve dhe institucioneve të tjera për zmadhimin e transparencës, llogaridhënies dhe hapjes për pjesëmarrje.

Rrjeti do të angazhohet për vendosjen e një strukture të re në procesin e PQH-së në Maqedoninë e Veriut në përputhje me përvojën ndërkombëtare, me qëllim që të përmirësohet komunikimi me të gjitha palët e përfshira dhe të përforsohet monitorimi dhe evalvimi i aktiviteteve. Rrjeti do të marrë pjesë dhe do të kontribuojë në vendosjen e një strukture të re për koordinim dhe monitorim të zhvillimit dhe zbatimit të PAN-it.

Struktura e re duhet ta mbindërtojë praktikën ekzistuese dhe resurset e angazhuara për PQH. Rrjeti duhet të nxitë dhe zmadhojë përkushtimin e pjesëmarrësve mbi zhvillimin e PAN-it nëpërmjet një procesi i cili i përfshin të gjitha palët e prekura, me përfshirje aktive të qytetarëve dhe shoqërisë qytetare.

## **Aktivitete**

Rrjeti do të marrë pjesë në përgatitjen e planit të ri aksionar, si dhe në krijimin e modelit, formimin dhe punën e trupit formal për koordinim dhe monitorim në përputhje me drejtimit dhe standardet e PQH-së (i a.q. Forum palëve të prekura; Komitet drejtues apo Këshill për PQH), d.m.th. model i organizuar dhe i vendosur për koordinim dhe pjesëmarrje të shoqërisë qytetare, institucioneve dhe palët e tjera të prekura në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të PQH-së.

Rrjeti do të kontribuojë që të formohet strukturë për konsultim dhe koordinim në shoqërinë qytetare midis Qeverisë, organizatave qytetare, qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara për dizajnim, zbatim, mbështetje, promovim dhe monitorim të prioriteteve dhe iniciativave të PQH-së.

Rrjeti do të mundësojë shkëmbim të ideve, njohurive dhe përvojave të organizatave qytetare për ndërtim të institucioneve publike më funksionale.

Me veprimin dhe zhvillimin e vet, rrjeti do t'u mundësojë anëtareve lidhje dhe mbindërtim të ndërsjellë të iniciativave të veçanta për pushtetet e hapura (si në nivel lokal ashtu edhe në nivel nacional), si dhe krijimi i projekteve të reja nëpërmjet rrjetit si platformë.

## **Vlera**

Vlerat themelore të PQH-së dhe të rrjetit përmbahen në *Deklaratën për Partneritet për qeverisje të hapur*.

Anëtarët e rrjetit më vete dhe rrjeti si tërësi i kanë vlerat themelore të Partneritetit për qeverisje të hapur:

- pjesëmarrje
- hapje dhe
- llogaridhënie.

Rrjeti duhet të mirëmbajë shpirtin e shoqërisë qytetare dhe të mundësojë hapësirë për iniciativë të hapur qytetare.

Rrjeti dhe anëtarët e tij nuk zbatojnë dhe nuk mbështesin aktivitete të cilat promovojnë dhe nxitin gjuhën e urrejtjes, diskriminimin e çdo lloji dhe korrupsionin.

Struktura dhe ekzistimi i rrjetit nuk duhet të varen nga ndryshimet politike, qeveritare dhe institucionale.

Në raport me relacionin me pushtetet, rrjeti do të ketë qasje të kombinuar: bashkëpunim me pushtetet gjatë krijimit dhe zhvillimit PAN-it; dhe kërkesë ndaj pushteteve dhe institucioneve që të jenë transparente dhe llogaridhënëse që të mundësojnë pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e politikave dhe vendimmarrjes.

## **Anëtare të rrjetit**

- Rrjeti është i hapur për pjesëmarrje të organizatave qytetare të cilat veprojnë në fusha të ndryshme, ndërsa angazhohen për pjesëmarrje qytetare në krijimin e politikave publike, transparencës dhe llogaridhënies së pushteteve;
- Anëtarët e rrjetit duhet të respektojnë dhe zbatojnë të njëjtat rregulla dhe parime të cilat i presin edhe nga pushtetet dhe institucionet: transparencë, llogaridhënie, pjesëmarrje, barazi gjinore, përfshirje të grupeve të marginalizuara etj.
- Anëtare e rrjetit do të marrin pjese në mbledhjet e PQH-së, do të jenë në listën e e-mail adresave të PQH-së, do të kontribuojnë në punën e PQH-së, do të nominojnë anëtare për Këshillin e PQH-së.

## **Struktura**

Procesin e formimit të rrjetit e udhëheq Këshilli Iniciues prej 10 organizatash qytetare. Këshilli Iniciues është trup i përkohshëm që do të ekzistojë deri në përzgjedhjen zyrtare dhe vendosjen e organeve të rrjetit.

Anëtarët e Këshillit Iniciues:

- Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave (ESE), Shkup, Darko Antiq, koordinator i programit për monitorim dhe analizë të buxheteve
- Shoqata për Promovim dhe Zhvillim të Shoqërisë Inkluzive INKLUZIVA, Bllagica Dimitrovska, presidente

- Qendra për Menaxhim me Ndryshimet (QMN), Martin Todevski, proekt-menaxher
- Asociacioni për Hulumtim, Komunikim dhe Zhvillim "Pablik", Klimentina Ilijevski, drejtoreshë e ekzekutive
- Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), Snezhana Kamillovska, projekt-koordinatore
- Shoqata e Qytetarëve "Qendra për Komunikime Qytetare" QKQ Shkup, German Fillkov, president i shoqatës
- Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia, Sunçica Kostovska-Petrovska, konsultuese për shoqëri qytetare
- Reaktor - Hulumtim në Aksion, Bllazhen Maleski, hulumtues
- Shoqata e Qytetarëve "Lubeznost", Toni Stankovski, president
- Fondacioni Metamorfozis, Bardhyl Jashari, drejtor ekzekutiv

Pas vendosjes së rrjetit do të përcaktohet struktura e tij. rrjeti do zë ketë Komitetin drejtues dhe koordinatorin e vet, me mandat, rol dhe mënyrë të përcaktuar të vendimmarrjes.

Do të kemi mundësi për ndryshime dhe rotacion në strukturë për që anëtarët e rinj të jenë në rrjedha me prioritetet dhe angazhimet e reja në planin aksionar.

Komiteti drejtues:

Koordinator: